



ASISTENCA E BE-SË PËR KOSOVËN
Përmirësimi i mjedisit







INFRASTRUKTURË FUNKSIONALE DHE TË PASTËR

Dëshira më e madhe e qytetarëve të Kosovës¹ është thjeshtë dëshira për një jetë normale. Ajo do të thotë paqe, rregull, arsim dhe punësim. Por gjithashtu nënkupton shërbime themelore dhe infrastrukturë për t'i siguruar ato. Këtu përfshihen shërbimet siç janë:

- Furnizim i besueshëm dhe i pranueshëm me ujë të pastër
- Mënjanim i shëndetshëm i ujërave të zeza dhe kanalizimit
- Mënjanim i mbeturinave komunale (plehrave)
- Furnizim i besueshëm me ngrohje dhe energji elektrike

Kjo gjithashtu nënkupton sigurimin e një mjedisi të pastër dhe të kënaqshëm, atë lloj mjedisi në të cilin qytetarët mund të gëzojnë një jetë normale dhe kohë për pushim. Për sa i përket të gjitha shërbimeve themelore BE-ja ka ndihmuar dhe vazhdon ta ndihmojë Kosovën.

Një çështje me të cilën të gjithë Kosovarët janë më se të njohur është mungesa e furnizimit me ujë për 24 orë në ditë, madje edhe në qytetet e mëdha. Furnizimi me ujë është çështje e një interesi vital jo vetëm nga këndvështrimi i komoditetit për qytetarët por gjithashtu edhe për shëndetin publik. Dhe situata në Kosovë ka qenë larg asaj që mund të quhet ideale për katër arsye:

- Së pari, ekzistojnë pak fabrikat për trajtimin e ujit dhe nuk e kanë kapacitetin e duhur.
- Së dyti, rrjetet ekzistuese të ujësjellësit janë në gjendje të dobët, që rezultojnë në humbje dhe rrezik të shtuar ndaj ndotjes.
- Së treti, ato rrjete nuk janë të mjaftueshme as edhe për pjesët të cilave u shërbejnë.
- Së katërti, rrjetet duhet të zgjerohen për tu shërbyer pjesëve të cilat janë tani janë pa furnizim me ujë.

Andaj sektori i ujit ka qenë prioriteti i lartë për BE-në në Kosovë. Në total BE-ja ka investuar rreth 60 milion euro gjer tani, ku fondet janë shfrytëzuar për të rinovuar fabrikat e trajtimit të ujit dhe stacioneve të pompave të ujit, instalimin e matësve të ujit, rehabilitimin dhe zgjerimin e rrjeteve, dhe në proces e sipër, përmirësimin e cilësisë së ujit.

¹ Sipas RKSKB /1244/1999



PËRMIRËSIMI I CILËSISË SË UJIT, ZVOGËLIMI I HUMBJEVE

Nëse marrin një shembull, BE-ja është duke investuar 2 milion euro në Prishtinë për të zëvendësuar 2 km të gypave të vjetruar të ujit. Projekti i cili pritet të përfundoj gjatë vitit 2011 jo vetëm se do të përmirësoj cilësinë e ujit por edhe do të zvogëloj humbjet e burimeve të pakta të ujit. Kjo do të ngritë kapacitetin: gypat e ri janë një metër në diametër, pothuajse dy herë më të gjerë se sa ato që kanë qenë, që nënkupton furnizim të përmirësuar të ujit për 70% të kryeqytetit.

Mitrovica dhe fqinjët e saj gjithashtu janë duke përfituar. BE-ja ka ofruar 13 miliona euro në zgjerimin dhe përmirësimin e fabrikës për trajtimin e ujit në Mitrovicë, e cila përpunon ujin nga liqeni i afërt dhe i shërben katër komunave. Kapaciteti i përpunimit është më se dyfishuar, duke u ngritur nga 450 litra në 1,000 litra në sekondë. Kjo do të përmirësojë furnizimin për më shumë se 250,000 njerëz, duke siguruar ujë për 12-18 orë në ditë që është përmirësim i dukshëm, duke pasur parasysh se njëra nga komunat është furnizuar me ujë vetëm katër orë në ditë! Pas përfundimit të përmirësimit, pika e radhës në agjendë është puna në rrjetet e distribucionit.

Por përmirësimi i situatës nuk është vetëm çështje e përmirësimit të fabrikave dhe rrjeteve. Nevojitet edhe sistemi i përshtatshëm rregullativ dhe menaxhues për të siguruar shërbime me standard të pranueshëm dhe me çmim të arsyeshëm. Për këtë arsye BE-ja është gjithashtu duke ofruar ndihmë zyrove rregullative qëndrore dhe rajonale në këtë sektor, përfshirë:

- Ndihmën për të caktuar një sistem të ri të tarifave
- Këshillimin në formulim dhe vlerësim të aseteve dhe planeve investuese
- Përmirësimin e kapacitetit të rregullatorit për të monitoruar aktivitetet e ujësjellësit për të siguruar përputhshmëri me rregulloret
- Përmirësimin e inkasimit të faturave për ujë dhe mbeturina

UJËRAT E ZEZA: RAST I PËRSHTATSHËM PËR TRAJTIM

Mënjanimi i duhur i ujërave të zeza është gjithashtu çështje vitale për shëndetin publik. Ajo është çështje brengosëse e cila sa shkon e rritet në Kosovë, ku mungesa e aranzhimeve për mënjanimin e tyre nënkupton që lumenjtë dhe burimet nëntokësore çdo herë e më shumë po rrezikohen nga kanalizimi. Në të njëjtën kohë fabrikat për trajtimin e ujërave të zeza (IMUZ) janë projekte mjaft të shtrenjta.



Riparimi i sistemit



//



Identifikimi i nevojës për fabrika e trajtimit.

Një projekt i tillë testues për fabrikën për mënjanim të ujërave të zeza është në Skenderaj. I kryer në 2007, ai është penguar që të fillojë punën për pak kohë për shkak të çështjeve pronësore, të cilat tani janë zgjidhur, sidoqoftë fillimi i punës do të ndodh në mars të vitit 2011.

BE-ja është duke ndërmarrë masa për të adresuar problemin e trajtimit e ujit për periudhë afatshkurtër dhe afatgjatë.

Në të njëjtën kohë, BE-ja është duke ndërtuar disa rrjete të kanalizimit që përfshijnë trajtimin komplet para shkarkimit. Tani janë në proces katër projekte me vlerë prej 3 miliona euro në total, të cilat i shërbejnë:

- Qytezës së Junikut
- Fshatrave Kukë dhe Kosavë (Komuna e Dragashit)
- Fshatit Skivjan (Komuna e Gjakovës)
- Fshatrave Medvec dhe Vrellë (Komuna e Lipjanit)

BE-ja po vazhdon edhe më tej: ka iniciuar strategji për ujin që e mbulon tërë Kosovën për të identifikuar nevojat për fabrika të trajtimit të ujërave të zeza. Investime të mëdha priten në objektet e teknologjisë së fundit siç është ajo në Skenderaj, që do të jetë e mirëseardhur për lumenjtë e Kosovës, ujësjellësin dhe për qytetarët.

PROGRAMI PËR TË MBYLLUR DEPONITË E PAIZOLUARA TË MBETURINAVE

Furnizimi me ujë dhe menaxhimi i ujërave të zeza nuk janë problemet e vetme me implikime në shëndetin publik të cilat adresohen me ndihmën nga BE-ja. Një problem tjetër është largimi i mbeturinave komunale.

Deponitë e hapura dhe të paizoluara të mbeturinave kanë paraqitur burim të rëndësishëm të problemeve shëndetësore, në veçanti për ata që jetojnë në afërsi. Mbeturinave nuk ndahen dhe të gjitha llojet e mbeturinave shtëpiake dhe ato industriale hidhen në deponi, duke shkaktuar probleme të ndotjes së ajrit, tokës dhe të ujit nëntokësor. Zjarret e shpeshta spontane në deponi nënkuptojnë mjaft shumë tym. Dhe njerëzit më të rrezikuar shpeshherë gërmojnë në këto pjesë duke kërkuar gjëra që riciklohen duke u rrezikuar nga ndotësit toksik.



PASTRIMI DHE MBUSHJA

BE-ja ka bërë përpjekje për të përmirësuar gjendjen që sa kohë.

Para disa vitesh, ndihmoi në ndërtimin e gjashtë deponive rajonale në të cilat ndërmarrjet komunale për pastrim sjellin mbeturinat e mbledhura, duke paguar një tarifë për t'i hedhur ato në deponi. Por kjo nuk mjaftonte. Si rrjedhojë e mospagesës nga ekonomitë shtëpiake dhe bizneset, shërbimet komunale preferonin hedhjen e mbeturinave pa paguar fare dhe në mënyrë joligjore në vendgrumbullimet ekzistuese komunale të mbeturinave.

Për këtë arsye BE-ja aktualisht është duke përkrahur programin për të mbyllur tetë deponi të pakontrolluara të mbeturinave komunale. Në kosto prej 3 milion euro të BE-së, kjo ka përfshirë mbushjen e deponive me argjilë dhe mbjellja e barit, drunjve dhe shkurreve. Ka filluar në mars 2010 dhe pritet të përfundoj deri në fund të pranverës së vitit 2011 dhe disa prej tyre do të transformohen në parqe komunale.

Si gjithmonë, përpjekjet e BE-së gërshetohen me veprimet lokale. Ministria e Mjedisit u ka bërë të qartë ndërmarrjeve komunale se do të përndjekë hedhjet joligjore të mbeturinave dhe do të shqiptojë gjoba. Kështu vet ndërmarrjet duhet të jenë më të përkushtuara në inkasimin e faturave për mbeturinat. Rezultati i fundit është: Kosova më e rregullt dhe më e pastër.

RRUGËT DHE URAT: ARRITJA DERI ATY

Dhe pasi që asnjë komunitet nuk mund të mbijetoj këto ditë pa qasje në rrugë, BE-ja është dashur të veproj edhe aty. Gjatë këtyre viteve, BE-ja ka bërë:

- Rindërtimin e afro 300 km të rrugëve magjistrale, duke mundësuar lidhje më të mira për njerëzit dhe për mallrat si në mes të qyteteve ashtu edhe me ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë, Malin e zi dhe Serbinë
- Rindërtimin e afro 20 urave, përfshirë 17 ura në M2, që lidh Kosovën me ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë. Këto ura kanë qenë në një gjendje tepër të dobët sa që kanë paraqitur rrezik për rrjedhën e trafikut të ngarkuar në këtë rrugë magjistrale në hyrje/dalje të Kosovës.
- Rindërtimin e afro 50 km të rrugëve më të vogla rajonale dhe vendore, të cilat gjithashtu janë të rëndësishme. Një rast i tillë është Skorobishta afër Prizrenit. Fshati praktikisht ka mbetur i izoluar gjatë periudhës së vjeshtës dhe dimrit. Kur u bë përirimi i rrugës së re, Kryetari i Komunës tha: "duke iu falënderuar BE-së, u realizua ëndrra e fshatarëve".

Punët e tilla gjithashtu krijojnë punësim dhe përmirësim të aftësive pasi që banorët lokale mësohen që të punojnë me standarde përkatëse Evropiane të ndërtimit dhe sigurisë.



FURNIZIMI I KOSOVËS ME ENERGJI



BE-ja ka shpenzuar mbi 400 milion euro në fushën e energjisë elektrike

Energjia elektrike është fushë esenciale në të cilën BE-ja e ka përkrahur Kosovën: gjatë dekadës së fundit, BE-ja ka shpenzuar më shumë se 400 milion euro.

Kosovarët nuk kanë nevojë që të përkujtohen se sa i pabesuar ishte sistemi i rrymës pas konfliktit të vitit 1999, apo për rolin e BE-së në riparimin e dëmeve dhe aranzhimin e importeve urgjente për të ndihmuar Kosovën gjatë dimrit të parë pas konfliktit.

Rindërtimi dhe modernizimi kërkon kohë, sidoqoftë, procesi i përmirësimit të centraleve dhe investimet në linjat e bartjes ka vazhduar shumë gjatë pas vitit 2000.

Puna në përmirësimin e infrastrukturës së energjisë elektrike të Kosovës vazhdon, siç vazhdon edhe përkrahja e BE-së.

Për shembull, BE-ja ka ndarë 17 milion euro nga 20 milion shpenzime për të hapur minierën e re të Sibocit jugperëndimor, e cila do të zëvendësoj minierën ekzistuese të thëngjillit që së shpejti do të boshatiset. BE-ja ka ngritur prodhimin për 50%, që përndryshe do të ishte mungesë për termocentralet kryesore e si rrjedhojë ndërprerje të rrymës pas vitit 2010/11.

BE-ja së fundi është duke ndihmuar eliminimin e “grykës së ngushtë” në rrjetin e distribucionit në perëndim dhe lindje të Kosovës ku kapaciteti joadekuat nënkupton se linjat e bartjes dhe stacionet e transformatorit me lehtësi mund të mbingarkohen.

Kjo situatë u rëndua më tej në vitin 2007 kur një avari në Bullgari shkaktoi ndërprerje të rrymës në të gjithë Kosovën. Që atëherë BE-ja ka financuar ndërtimin e 2 nënstacioneve të reja në Ferizaj (6 milion euro) dhe një përmirësim të madh të nënstacionit në Prizren në jug (11 milion euro), ku kjo e fundit përfshinë sistemin TI që është vital për të menaxhuar me të dhënat e energjisë elektrike.



EFIKASITETI I ENERGJISË ZVOGËLON KËRKESËN

Përveç bartjes së energji në distancë të gjatë, BE-ja është duke marrë pjesë në furnizim të ngrohjes. Mitrovica dhe shërbimi i saj për ngrohje Termomit janë rastet në fjalë. Një projekt i përkrahur nga BE-ja ka rinovuar dhe ri-pajisur objektin për ngrohje Termomit duke ngritur kapacitetin e saj nga 9.3 MW në 38 MW, dhe ka zgjeruar rrjetin e ngrohjes në pjesën jugore të qytetit.

Investimet mundësojnë Termomitin që të ngroh në mënyrë më efikase dhe të furnizoj mbi 2,000 ekonomi familjare dhe biznese dhe objekte të shumta publike, gjë që ka përmirësuar jetën e qytetarëve të Mitrovicës.

Në fund, BE-ja është fokusuar në eficiency e energjisë. Shfrytëzimi i kotë i energjisë i nxitur nga çmimet të ulëta në të kaluarën, ka qenë një ndër shkaktarët e ndërprerjes së rrymës. Andaj BE-ja ka zhvilluar një numër projektesh për të nxitur shfrytëzimin më të mirë të energjisë.

Një projekt prej 1.3 milion euro investime në masat e energjisë eficiente të shpenzimit të energjisë për katër shkolla dhe një spital në masat siç janë instalimi i ngrohësve me energji solare, ndërrimi i dyerve dhe dritareve dhe shfrytëzimi i sistemit efikas të ngrohjes.

BE-ja shpreson se me këto jo vetëm që do të kursehen të hollat e institucioneve në fjalë, por do të tregoj se çfarë mund të arrihet. Për të shpërndarë këtë porosi tutje, BE-ja ka financuar një fushatë mediale për të promovuar eficiency në energji.

BE-ja ka financuar edhe kursin e parë të aftësimin në Kosovë për të kualifikuar auditorët e energjisë, specialistët në identifikimin e masave të eficiency në energji.



Ngritja e vetëdijes lidhur me masat e eficiency së energjisë



DIVERSIFIKIMI I MUNDËSIVE PËR PUNËSIM RURAL



BE-ja është duke punuar me qytetarët për të siguruar një Kosovë më të pastër dhe më të gjelbër

FUQIZIMI I SHOQËRISË CIVILE

Duke e kryer pjesën e vet për të siguruar se njerëzit e Kosovës kanë ujë, rrymë elektrike dhe ngrohje, BE-ja është gjithashtu duke ndihmuar me masat për të krijuar një mjedis të këndshëm dhe të ngritë mundësitë e fituar për jetesë në mënyrë të këndshme. Për shembull BE-ja ka përkrahur një projekt me vlerë prej përafërsisht 3 milion euro me qëllim të ngritjes së kontributit në pylltari dhe bujqësi për të diversifikuar punësimin dhe mundësitë për të ardhura në vendet rurale. Me pyje të shumta dhe kafshët e egra të shumëllojshme, Kosova ka potencial të konsiderueshëm për pylltari dhe për gjueti dhe turizëm të "gjelbër". Por ky potencial duhet të konservohet dhe të menaxhohet. Sipas përvojës së BE-së, ky projekt përfshin:

- Masat për të përmirësuar menaxhimin e parqeve nacionale, biodiversitetin dhe parandalimin e zjarreve në pyje
- Krijimin e një rrjeti rrugor natyral nëpër pyje
- Planifikimin dhe udhëzimet për ngritjen e vetëdijes publike për të luftuar prerjet ilegale të pyllit; dhe
- Masat për ndërtimin e kapacitetit në administratën pyjore dhe për pronarët e pyjeve private

Vitale janë edhe iniciativat mjedisore të cilat edhe pse janë më të vogla në aspektin financiar, funksionojnë duke mobilizuar njërin nga burimet kryesore të Kosovës, iniciativën e qytetarëve të saj, duke fuqizuar "shoqërinë civile". Me anë të trajnimeve dhe ndihmës së vogël financiare, organizatat jo-qeveritare (OJQ-të) janë:

- Të inkurajuar që të punojnë së bashku me njëra-tjetrën, me komunitetet dhe me autoritetet lokale dhe shtetërore
- Të informuara mbi praktikën më të mirë ndërkombëtare
- Të trajnuara për zhvillimin e fushatave për të ngritur vetëdijen mbi çështjet mjedisore dhe për përgatitjen e materialeve edukative, dhe
- Të njohura me mënyrën se si të kontribuohet në bërjen e politikës mjedisore

Tani në proces janë dy projekte të tilla, njëra ka për qëllim që të promovoj biodiversitetin ("EKOsovo") dhe tjetra të fuqizoj rolin e Asociacionit të Ekologëve dhe të Fermerëve të Kosovës në mbrojtjen e mjedisit dhe në veçanti në promovimin e riciklimit të mbeturinave dhe kompostimin. Në vlerë prej 126,000 euro dhe 129,000 euro, respektivisht, projektet financohen 90% nga BE-ja. Kjo është një dëshmi mbi përkushtimin e BE-së për një Kosovë më të mirë, më të pastër, më të gjelbëruar, më të shëndetshme dhe me të gjitha shërbimet elementare!





KONTAKTI

Zyra ndërlidhëse e Komisionit Evropian në Kosovë

A. Rruga Kosova 1 (P.O. Box 331)
Prishtinë, KOSOVË

T. +381 38 51 31 200

F. +381 38 51 31 304

E. delegation-kosovo@ec.europa.eu

W. www.delprn.ec.europa.eu

“Ky botim është hartuar me ndihmën e Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e vetme e Zyrës Ndërlidhëse të BE-së në Kosovë dhe në asnjë mënyrë nuk konsiderohet se pasqyron qëndrimet e Bashkimit Evropian.”

